



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE
Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. +355 4 2224 572 Fax. +355 4 2270 627 www.moe.gov.al

RREGULLORE
(Nr. 1, datë 25.03.2009)

PER
PROCEDURAT E VLERESIMIT DHE MIRATIMIT TË
PROJEKTEVE TË MEKANIZMIT PËR ZHVILLIM TË PASTËR
(CDM)

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të gërmës "d" të nenit 18 të ligjit nr. 9890, datë 20.03.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1553, date 26.11.2008 "Për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të Protokollit të Kiotos ", Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave miraton këtë rregullore:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i kësaj Rregulloreje janë:shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve, projektideve dhe i projekteve CDM që paraqiten nga propozues të ndryshëm në kuadër të Protokollit të Kiotos, si të përshtatshëm për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi

1. Rregullorja synon të përcaktojë rregullat dhe procedurat që zbatojnë Autoriteti i Caktuar Kombëtar dhe Sekretariati i tij Teknik për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve CDM të paraqitur nga propozuesit.

2. Rregullat dhe procedurat që cakton kjo rregullore për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve CDM, janë detajim dhe konkretizim i Procedurës së miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1553, date 26.11.2008 "Për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të Protokollit të Kiotos ".

3. Rregullorja përcakton gjithashtu, detyrat e veçanta të Sektorëve të ndryshëm të Ministrisë në procesin e shqyrtimit dhe të miratimit të projekteve CDM, si dhe në kuadër të angazhimeve ligjore të ministrisë për plotësimin e kërkesave që burojnë nga qenia palë në Protokollin e Kiotos.

Neni 3

Përkufizimi i termave

Termat e veçantë që përdoren në fushën e CDM dhe në këtë rregullore, janë përkufizuar e janë renditur në Aneksin 9 që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje si pjese e saj

KREU II

FUNKSIONET E DETYRAT E AUTORITETI TE PËRCAKTUAR KOMBËTAR, TE SEKRETARIATIT TE TIJ DHE TE STRUKTURAVE TE MINISTRISË

Neni 4

Funksionet e Komitetit të CDM-së

Komiteti i CDM-së është organizëm i ngritur posaçërisht për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve CDM si më poshtë:

1. Vlerëson projektet CDM, në përputhje me rregullat dhe procedurat e kësaj rregulloreje;
2. I sugjeron Ministrit të nënshkruaj Letrat e Pranimit dhe të Miratimit të propozimeve e të kërkesave për projektet CDM;
3. Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Sekretariatit Teknik në shërbim të tij.

Neni 5

Funksionet dhe detyrat e Sekretariatit Teknik të CDM-së

Aktivitetet e DNA-së mbështeten nga Sekretariati Teknik i CDM-së, që është në shërbim të Komitetit të CDM-së. Në këtë kuadër dhe në zbatim të përgjegjësi që i ngarkon VKM nr.1553, datë 26.11.2008, i përmendur në pikën 2 të nenit 2 të kësaj rregulloreje, ai kryen këto detyra:

1. Lehtëson punën e Komitetit në procesin e paraqitjes, vlerësimit dhe miratimit të dokumenteve të projektit CDM;
2. Ndhmon zhvilluesin e projektit, duke e informuar për udhëzues, formate apo materiale të tjera të vlefshme, të nivelit ndërkombëtar dhe kombëtar që i nevojiten;
3. Sugjeron nisma për akte ligjore e nënligjore të nevojshëm për mbarrvajtjen e procesit të miratimit të CDM-së;
4. I komunikon informacionet përkatës Entitetit të Caktuar Operacional (DOE);
5. Parashtron kërkesa për raportin e ekspertit për PDD;
6. Krijon dhe mirëmban bazën kombëtare të të dhënave për CDM-në, për regjistrimin e Dokumenteve për Hartimin e Projektit;
7. Studjon dosjen dhe dokumentat e paraqitura zyrtarisht nga propozuesi i projektit (psh. PIN, PDD) dhe përgatitjen e raporteve të vlerësimit, që do të shqyrtohen nga Komiteti i DNA-së dhe e shoqëron dosjen me mendimin e tij me shkrim;
8. Përgatit draft-letrat e pranimit dhe të miratimit, mbi bazën e formatit të miratuar për lëshim nga DNA-ja;

9. Organizon seminare, takime pune, etj. me grupet e interesit e me aktorët përkatës për nxitjen e CDM-së dhe për rritjen e njohurive të tyre në këtë fushe;
10. Merr pjese dhe përfaqëson vendin në veprimtari ndërkombëtare të organizuara nga Protokolli e nga Konventa;
11. Raporton rregullisht për aktivitetet e tij përpara Komitetit të DNA-së.
12. Përgatit dhe jep informacionet për Sekretariatit e UNFCCC-së lidhur me ndryshimet në DNA;

Neni 6

Sektori i Projekteve

1. Në përputhje me funksionet dhe detyrat e tij funksionale, Sektori i Projekteve ndjek ecurinë dhe zbatimin e projekteve CDM, pasi ato janë miratuar.
2. Për të monitoruar ecurinë e zbatimit të projekteve CDM, Sektori i Projekteve përcakton indikatorët, si dhe dokumentat me të cilat zbatuesi i projektit raporton zbatimin, si dhe kohën e dorëzimit të tyre në sektor.
3. Për secilin projekt CDM të futur në fazën e zbatimit, Sektori mban një dosje të veçantë, ku sistemohen gjithë dokumentat që kanë të bëjnë me zbatimin e projektit CDM.

Neni 7

Sektori IT dhe Komunikimit

Në kuadër të detyrave për ndjekjen e Projekteve CDM, Sektori IT dhe Komunikimit, në përputhje me funksionet dhe detyrat e tij funksionale:

1. Në faqen e ministrisë në internet , hap një faqe të veçantë për CDM;
2. Regjistron projektin në bazën e të dhënave kombëtare të CDM-së, pasi ai të jete miratuar;
3. Shpërndan të dhënat dhe informacionet që disponon Ministria për projektet CDM;
4. Përsos dhe mirëmban bazën e të dhënave, të aksesueshme nga publiku, lidhur me projektet e miratuara CDM dhe çdo informacion tjetër që ka të bëjë me procesin e CDM-së;
5. Angazhohet në veprimtaritë për ndërgjegjësimin e publikut lidhur me përfitimet e zbatimit të çdo projekti CDM.

Neni 8

Drejtoria e VNML dhe Komisioni i Lejeve

1. Në kuadër të detyrave për ndjekjen e Projekteve CDM, Drejtoria e VNML dhe Komisioni i Lejeve, në përputhje me funksionet dhe detyrat e tyre funksionale, shqyrtojnë dhe paraqesin për miratim të Ministrit pajisjen me leje mjedisore të projektit CDM që, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar dhe të ligjit nr. 8990, date 23.01.2003 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis", i ndryshuar, duhet të pajiset me leje mjedisore.

2. Shqyrtimi dhe pajisja me leje mjedisore, sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet përpara se projekti të miratohet si projekt CDM.

Neni 9

Njesia e Projektit te Ndryshimeve Klimatike

Njësia e projektit (Programi) për Ndryshimet Klimatike, e mbështetur nga UNDP-ja për të ndihmuar Ministrinë në çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike, shërben si pikë kontakti për asistencë, informim, komunikim, ndërgjegjesim dhe mobilizim fondesh në çështjet e ndryshimeve të klimës. Në këtë kuadër, Programi organizon trajnime dhe jep në vazhdimësi, për një periudhë afat-shkurtër, ndihmën e nevojshme Komitetit të CDM, Sekretariatit të tij dhe strukturave të tjera të Ministrisë për të përballuar detyrat e tyre në kuadër të veprimtarive për zbatimin e kërkesave të Protokollit të Kiotos.

KREU III

PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË PROJEKTIT CDM

Neni 10

Pranimi i kërkesës dhe futja në procedurat e shqyrtimit

1. Në përputhje dhe në zbatim të VKM së përmendur në pikën 2 të nenit 2 të kësaj rregulloreje, kërkesa dhe dokumentat e propozimit për një projekt CDM, fillimisht administrohen nga Sekretariati Teknik, i cili i përgatit për tu shqyrtuar në Komitet.
2. Në procesin e shqyrtimit e miratimit të propozimit për një projekt CDM, Komiteti dhe Sekretariati Teknik, zbatojnë afatet e përcaktuar në VKM-në e përmendur në pikën 1 të këtij neni

Neni 11

Studimi dhe mbështetja e projekt-idesë (PIN)

1. Shqyrtimi dhe procedurat e miratimit të projektit CDM përbëhen nga dy faza dhe një numër hapash për secilën fazë si më poshtë:
2. **Faza 1** quhet “Studimi dhe mbështetja e projekt-idesë (PIN)”. Qëllimi i kësaj faze është të përcaktohet nëse projekti kualifikohet për CDM, si dhe për të ndihmuar vlerësimin e mëtejshëm më në thellësi (faza PDD) duke kontrolluar përputhjen e projekt-idesë me kërkesat e përgjithshme të CDM-së dhe me legjislacionin kombëtar në një fazë të mëparshme. Ky vlerësim paraprak do të bëhet në bazë të PIN-it (Aneks 2) i cili e sistematizon informacionin rreth projektit si dhe në bazë të kërkesës së zhvilluesit të projektit për një Letër Pranimi (Aneks 3). Kjo fazë ka katër hapa si më poshtë:

Hapi 1: Zhvillimi i Shënimit për projekt-idenë (PIN);

Hapi 2: Studimi fillestar i PIN-it;

Hapi 3: Mbështetja e PIN-it;

Hapi 4: Lëshimi i një Letre Pranimi (LP).

3. Përshkrimi i detajuar i secilit prej hapave të mësipërm jepet në Aneksin 1 që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje si pjesë e saj.
4. Në rastet e Memorandumeve të Mirëkuptimit ose Marëveshjeve midis palëve për zbatimin e Protokollit të Kiotos, të zbatuara nëpërmjet Komiteteve të përbashkëta respektive me pjesëmarrjen e Ministrisë, të cilat identifikojnë projekte specifike CDM, për këto projekte Letra e Pranimi nuk është e nevojshme.

Neni 12

Vlerësimi i Dokumentit të Hartimit të Projektit (PDD)

Faza 2 e quajtur ‘Vlerësimi i Dokumentit të hartimit të Projektit (PDD)’, shërben për të përcaktuar nëse projekti duhet të miratohet si një projekt CDM. Ky është një vlerësim shumë më i detajuar nga ai i fazës së parë të PIN-it dhe kërkon vlerësimin teknik të elementeve dhe të të dhënave kyçe që lidhen me projektin përkundrejt kriterëve për një Zhvillim të Qendrueshëm Kombëtar.

Kjo fazë bazohet në një PDD të përpiluar në përputhje me formatin standart të miratuar nga Bordi Ekzekutiv i CDM. Përshkrimi i detajuar i kësaj faze e i secilit hap, jepet në Aneksin 1 që i bashkelidhet kësaj rregulloreje si pjesë e saj. Kjo fazë ka pesë hapa si më poshtë:

Hapi 5: Zhvillimi dhe paraqitja e PDD-së;

Hapi 6: Konsultime publike për PDD-në;

Hapi 7: Shqyrtimi i PDD-së;

Hapi 8: Vlerësimi dhe Miratimi i PDD-së;

Hapi 9: Lëshimi i Letres së Miratimit (LM-së).

2. I gjithë procesi i miratimit të projektit perfundon brenda afateve të përcaktuara në VKM e përmendur në pikën 2 të nenit 2 të kësaj rregulloreje. Kjo kohë përfshin vetëm aktivitetet e Komitetit dhe të Sekretariatit Teknik për shqyrtimin dhe vlerësimin e projektit CDM dhe jo përgatitjen e dokumenteve të projektit nga zhvilluesi i projektit.

Neni 13

Kërkesat për Zhvilluesin e Projektit CDM

Në mënyrë që të merret miratimi për projektin sipas CDM-së, zhvilluesi i projektit paraqet zyrtarisht para DNA-së dokumentet e mëposhtme si në shqip edhe në anglisht, në formë të printuar dhe elektronike:

1. Formën e aplikimit drejtuar DNA-së shqiptare ku kërkohet miratimi i vendit pritës dhe ku jepen informacionet për kontaktet e zhvilluesit të projektit, sipas Aneksit 4 bashkëlidhur kësaj Rregulloreje;
2. Fotokopje e Letrës së Pranimit, lëshuar nga DNA-ja e Shqipërisë pas paraqitjes së PIN-së, sipas Aneksit 5 bashkëlidhur kësaj Rregulloreje;
3. Një Dokument të Hartimit të Projektit (PDD) i zhvilluar në përputhje me formatin, kërkesat dhe udhëzimet e Bordit Ekzekutiv të CDM-së¹;
4. Përmbledhje ekzekutive e Projektit që përshkruan karakteristikat kryesore të projektit dhe evidenton kontributin që ai jep në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit;
5. Një Vlerësim të Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas kërkesave të legjisllacinit mjedisor shqiptar, nëse është nevoja. Kjo varet nga lloji i projektit. Nëse një VNM është i nevojshëm dhe nuk është përfunduar, Letra e Miratimit do të jetë e kushtëzuar nga rezultati i VNM-së;
6. Deklarimin e pjesëmarrjes vullnetare në projektin CDM, sipas Aneksit 6 bashkëlidhur kësaj Rregulloreje;

7. Nëse ka më shumë se një palë të përfshirë në një projekt CDM, zhvilluesi i projektit tregon dokumente që vërtetojnë se ai i ka të drejtat mbi shkarkimet e reduktuara të gazrave serre;
8. Çdo dokument ose informacion, nëse kërkohet në Letrën e Pranimit të lëshuar nga DNA-ja e Shqipërisë në përgjigje të PIN-it;
9. Dokumente të tjera mbështetëse sipas dëshirës së zhvilluesit të projektit, si për shembull: një raport paravleftësimi, marrëveshje për blerjen e energjisë, studim të fizibilitetit, etj.

KREU IV

KRITERET PËR ZHVILIM TË QENDRUESHËM KOMBËTAR

Neni 14

Kriteret për zhvillim të qendrueshëm kombëtar

Në mënyrë që të miratohet projekti CDM dhe për të të lëshohet Letra e Miratimit, Autoriteti i Caktuar Kombëtar vlerëson:

1. Kontributin e projektit CDM nga pikëpamja e zhvillimit të qendrueshëm të vendit;
2. Rezultatet që do të arrijë në reduktimin e shkarkimit të gazrave sere.

Neni 15

Vlerësimi

Kriteret e Zhvillimit të Qendrueshëm Kombëtar për Shqipërinë ndahen në katër grupe dhe secili prej tyre ka një peshë në përputhje me kontributin që projekti jep për arritjen e zhvillimit të qendrueshëm, si dhe shoqërohet me nën-kritere për secilin grup, si më poshtë:

1. Kritere mjedisore (40% te vlerësimit)

- a. Kontribut për zbutjen e ndryshimeve klimatike;
- b. Përfitime të tjera mjedisore, si përmirësimi i cilesisë së ajrit, i ujit, i tokës, mbrojtja e biodiversitetit, manaxhimi i pyjeve etj;
- c. Mënyra e përdorimit të burimeve natyrore dhe konservimit të burimeve lokale.

2. Kritere ekonomike (30% te vlerësimit)

- a. Përfitimi financiar i entitetit/entiteteve të projektit;
- b. Transferimi i teknologjisë së re, përfshi kursimin e energjisë dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme;
- c. Tërheqjen e investimeve të huaja.

3. Kritere Sociale (15% te vlerësimit)

- a. Zbutja e varfërisë;
- b. Zhvillimi i kapaciteteve për aktorët e përfshirë;
- c. Konsultimet publike;
- d. Punësimi.

4. Përputhja me politikën kombëtare (15% te vlerësimit), nënkupton kontributet dhe përputhshmërinë me politikat dhe përparësitë e Qeverisë në nivelet kombëtare, rajonale e sektoriale.

Neni 16

Plotesimi i formulareve

1. Sistemi i peshës në përqindje i plotësimit të treguesve dhe i pikëve për vlerësimin e projektit CDM sipas kriterëve të zhvillimit të qëndrueshëm, jepen në tabelën e Aneksit 7 që i bashklidhet kësaj Rregulloreje si pjesë e saj.

2. Pas vlerësimit të plotë të projektit, vlerësuesi mbush formatin e formës së vlerësimit sipas Aneksit 8 që i bashklidhet kësaj Rregulloreje, përfshi propozimin për miratim ose për refuzim të projektit.

Neni 17

Pagesa e tarifës së shërbimit

Tarifa e shërbimit prej 50 000 lekesh paguhet kur zhvilluesi i projektit paraqet kërkesën për shqyrtim dhe miratim të projektit CDM dhe është e pakthyeshme edhe në rastet kur projekti nuk miratohet.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Lufter XHUVELI

Aneksi 1

Përshkrim i detajuar i procesit të miratimit të projektit CDM, duke përfshirë hap pas hapi të gjitha aktivitetet, organizimin/personin

përgjegjës për përmbushjen e tyre, si dhe afatet e përafërta për kryerjen e secilit hap.

FAZA E PARË: STUDIMI I IDESË SË PROJEKTIT	
Hapi 1: Hartimi i Shënim-Idesë së Projektit (PIN)	
Kryer nga:	Zhvilluesi i Projektit
Paraqitur tek:	Sekretariati Teknik i DNA-së
Përshkrimi i hapit:	Zhvilluesi i Projektit zhvillon një PIN dhe e paraqet atë zyrtarisht përpara Sekretariatit të DNA-së së bashku me një formë aplikimi dhe dokumente të tjera përkatëse sipas nevojës. Dokumentacioni paraqitet në shqip dhe në anglisht, si edhe në formë të shtypur dhe elektronike.
Hapi 2: Studimi fillestar i PIN-it	
Kryer nga:	Sekretariati i DNA-së
Paraqitur tek:	Kryetari i DNA-së
Përshkrimi i hapit	Sekretariati kontrollon nëse dokumenti i paraqitur është i plotë dhe i jep një numër projektit. Sekretariati kryen një shqyrtim të brendshëm të PIN-it (nëse është i nevojshëm edhe inputi i ekspertëve të tjerë) dhe përgatit një raport përmbledhës mbështetës për kryetarin e DNA-së, duke përfshirë rekomandimin e tij për nxjerrjen e një Letre Pranimi. Një draft-letër pranimi i bashkëngjitet raportit. Regjistrimi i projektit në bazën e të dhënave kombëtare të CDM-së duhet bërë vetëm pas marrjes së mbështetjes.
Hapi 3: Mbështetja e PIN-it	
Kryer nga:	Kryetari i DNA-së
Përshkrimi i hapit:	Bazuar në raportin përmbledhës të mbështetjes përgatitur nga Sekretariati, kryetari i DNA-së vendos nëse do ta mbështesë projekt-

	idenë ose nëse do ta refuzojë atë.
Hapi 3: Dhënia e Letrës së Pranimit (LP)	
Kryer nga:	Kryetari i DNA-së
Paraqitur nga:	Zhvilluesi i projektit
Përshkrimi i hapit:	Në rast të një vendimi pozitiv nxirret një Letër Pranimi (LP) dhe i dërgohet Zhvilluesit të Projektit nga Kryetari i DNA-së. Çdo rekomandim për përmirësime të projektit mund të përfshihet në letrën shoqëruese. Në rast refuzimi, DNA-ja duhet të dërgojë një letër ku të shpjegohen arsyet për këtë refuzim.
FAZA E DYTË: VLERËSIMI I DOKUMENTIT TË HARTIMIT TË PROJEKTIT	
Hapi 5: Zhvillimi dhe paraqitja e PDD-së	
Kryer nga:	Zhvilluesi i projektit
Paraqitur tek:	Sekretariati teknik i DNA-së
Koha e përafërt e përmbushjes:	Sipas vendimit të zhvilluesit të Projektit
Përshkrimi i hapit:	Pas marrjes së LP-së, zhvilluesi i projektit duhet të hartojë një Dokument të Hartimit të Projektit (PDD), i cili duhet të përgatitet në formatin e miratuar nga BE-ja i CDM-së. Zakonisht PDD-ja zhvillohet me ndihmën e konsulentëve.
Hapi 6: Konsultime publike rreth PDD-së	
Kryer nga:	Sekretariati Teknik i DNA-së
Paraqitur tek:	Publiku
Përshkrimi i hapit:	Sekretariati e ndan PDD-në me publikun për komente duke e botuar në faqen e DNA-së në Internet. PDD-ja do të qarkullohet gjatë kësaj periudhe me të gjitha palët e interesuara. Çështjet e konfidencialitetit duhen marrë parasysh.

	Sekretariati mbledh dhe sistemon komentet e marra.
Hapi 7: Shqyrtimi i PDD-së	
Kryer nga:	Komiteti i DNA-së
Përshkrimi i hapit:	Pas konfirmimit të plotshmërisë së dokumentacionit të PDD-së, Sekretariati i dërgon kopje për shqyrtim Komitetit të DNA-se. Çdo anëtar i Komitetit të DNA-se, në rast nevojë për ekspertizë të specializuar, mund të kërkojë që Komiteti të marrë mendimin e ekspertit nga institucionet përkatëse nëpërmjet Sekretariatit.
Hapi 8: Vlerësimi dhe Miratimi i PDD-së	
Kryer nga:	Komiteti i DNA-së
Paraqitur tek:	Kryetari i DNA-së
Përshkrimi i hapit:	Secili ekspert nga Komiteti i DNA-se kryen vlerësimin e ndikimeve të projektit në zhvillimin e qëndrueshëm duke përdorur skemën e vlerësimit. Komiteti merr një vendim lidhur me miratimin/refuzimin e projektit, bazuar në rezultatet e vlerësimit, komentet e marra nga publiku dhe opinionin e ekspertit nëse një gjë e tillë është bërë. Vendimi lidhur me miratimin/refuzimin merret me konsensus.
Hapi 9: Dhënia e LM-së	
Kryer nga:	Kryetari i DNA-së
Paraqitur tek:	Zhvilluesi i projektit
Përshkrimi i hapit:	Në rast të një vendimi pozitiv lidhur me miratimin, kryetari i DNA-së nënshkruan një LM drejtuar zhvilluesit të projektit. Në rast refuzimi, letra duhet të përmbajë arsyet e refuzimit.

Aneksi 2

Formati i një Shënimi për Projekt-Ide (PIN)

SHËNIM PËR PROJEKT-IDE (PIN)

A. Përshkrimi i projektit, lloji, vendndodhja dhe kalendari

Tiulli i Projektit: _____

Data e dorëzimit: _____

Përmbledhje teknike e projektit

Objektivi i Projektit	<i>Përshkruani në më pak se 5 radhë</i>
Përshkrimi i Projektit dhe aktivitetet e propozuara	<i>Rreth gjysëm faqeje</i>
Teknologjia e përdorur	<i>Përshkruani në më pak se 5 radhë. Ju lutem vini re se mbështetja mund t'i jepen vetëm projekteve që përdorin teknologji që është e mundur të futet në punë në mënyrë komerciale. Do të ishte me vlerë të jepeshin disa shembuj rreth asaj se ku është përdorur teknologjia e propozuar.</i>

Zhvilluesi i projektit	
Emri i zhvilluesit të projektit	
Kategoria organizative	☐ Qeveri ☐ Agjenci qeveritare ☐ Bashki ☐ Kompani private ☐ Organizatë jo-qeveritare
Funksion/e të tjera të zhvilluesit të projektit brenda projektit	☐ Sponsor ☐ Entitet operacional nën CDM-në ☐ Ndërmjetës ☐ Këshilltar teknik
Përmbledhje e përvojës përkatëse të zhvilluesit të projektit	<i>Përshkruani në më pak se 5 radhë.</i>
Adresa	<i>Adresa, Kutia Postare, Qyteti, Shteti</i>
Personi i kontaktit	<i>Emri i Menaxherit të Zhvillimit të Projektit</i>
Telefon / fax	
E-mail dhe adrese faqeje Interneti nëse ka	
Sponsorët e projektit	
<i>(Rendisni dhe jepni informacionin e mëposhtëm për të gjithë sponsorët e projektit)</i>	
Emri i sponsorit të Projektit	
Kategoria organizative:	☐ a. Qeveri ☐ b. Agjenci qeveritare ☐ c. Bashki ☐ d. Kompani private ☐ e. Organizatë jo-qeveritare
Adresa (përfshi adresën në Internet nëse ka)	<i>Adresa, Kutia Postare, Qyteti, Shteti</i>
Aktivitetet kryesore	<i>Jo më shumë se 5 radhë</i>
Përmbledhje e financave	<i>Përmbledhje financat (asetet në total, të ardhurat, fitimi etj.) në jo më shumë se 5 radhë.</i>
Lloji i Projektit	
Gazrat Serrë të vënë në shenjestër	☐ CO ₂ / CH ₄ / N ₂ O / HFCs / PCFs / SF ₆ <i>(përmendni gazrat respektivë)</i>
Lloji i aktiviteteve	☐ Pakësimi / Sekuestrimi i CO ₂
Fusha e aktiviteteve	
a. Furnizimi me energji	☐ Energjia e rinovueshme, përjashto biomasën/ biomasa / bashkëgjenerimi/ përmirësimi i efikasitetit të energjisë duke zëvendësuar pajisjet ekzistuese/minimizimi i transportit dhe shpërndarjes/ ndryshimi i lëndëve djegëse/ p.sh. nga qymyri në biomasë. <i>(përmendni ato që vlen në këtë rast)</i>

b. Kërkesa për energji	Zëvendësimi i “pajisjeve shtëpiake” ekzistuese/përmirësimi i efikasitetit të energjisë së pajisjeve ekzistuese që e prodhojnë atë (përmendni ato që vlejné në këtë rast)
c. Transporti	Motorrë më efikasë për transport/ndryshim modeli/ ndryshim i lëndës djegëse (psh. autobusët e transportit publik që punojnë me gaz natyror) (përmendni ato që vlejné në këtë rast)
d. Administrimi i mbetjeve	Kapja e çlirimit të metanit në “landfill”-e/ përdorimi i shkarkimeve nga mbetjet dhe mbetjet ujore (përmendni ato që vlejné në këtë rast)
Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjet	Pyllëzimi/Ripyllëzimi/menaxhimi i pyjeve/manxhimi i lagunave/ menaxhimi i deltave/shtretërve/ bujqësi e përmirësuar/parandalim i degradimit të tokës (përmendni ato që vlejné në këtë rast)
Metodologjia bazë që do të përdoret	Metodologjia bazë ekzistuese (përmendi emrin dhe referencën e Metodologjisë siç është paraqitur nga Bordi Ekzekutiv) Metodologjia e re bazë (përmendni ato që vlejné në këtë rast)
Vendndodhja e Projektit	
Rajoni	Azia Lindore dhe Paqësori/Azia Jugore/ Azia Qendrore/ Lindja e Mesme/Afrika Veriore/ Afrika sub-Saharine/ Afrika Jugore/ Amerika Qendrore dhe Karaibet/ Amerika Jugore/ Europa Qendrore dhe Lindore (përmendni ato që vlejné në këtë rast)
Shteti	
Qyteti	
Përshkrim i shkurtër i vendndodhjes së Projektit	Jo më shumë se 3-5 radhë
Kalendari i pritshëm	
Data më e afërt e fillimit të projektit	Viti në të cilin do të fillojë funksionimi i impiantit
Koha e përafërt e nevojshme përpara fillimit të funksionimit pas miratimit të PIN-it	Koha e nevojshme për angazhimet financiare: xx muaj Koha e kërkuar për çështjet ligjore: xx muaj Koha e kërkuar për negociata: xx muaj Koha e kërkuar për ndërtim: xx muaj
Koha kur pritet reduktimi i verifikuar i shkarkimeve ose dorezimi i CER-eve	Viti
Kohëzgjatja e Projektit	Numri i viteve
Statusi ose Faza aktuale e projektit	Faza e identifikimit dhe para-përzgjedhjes/ studimi i mundësive i përfunduar/ studimi i fizibilitetit i përfunduar/ faza e negociatave/faza e kontraktimit/ etj./ (përmendni atë që ka rëndësi në këtë rast si dhe tregoni dokumentacionin që mund të vihet në dispozicion [p.sh. studimi i fizibilitetit])
Statusi aktual i pranimit të Vendi Pritës	Letër Pranimi e disponueshme/Letër Pranimi në diskutim e sipër ose e përgatitur/ Letër Miratimi e disponueshme/Letra e Miratimit është në diskutim e sipër ose e përgatitur/Marrëveshja me Vendi Pritës është në diskutim e sipër ose e nënshkruar /Memorandumi i mirëkuptimit është në diskutim e sipër ose i nënshkruar / etj. (përmendni ato që nevojiten në këtë rast)

B. Përfitimet e pritshme mjedisore dhe sociale

Gazrat Serrë që vlerësohet se janë pakësuar/ sasia e sekuestruar e CO₂ (në tonë metrikë të ekuivalentit të CO₂)	Vjetore: Deri në dhe duke përfshirë vitin 2012: xx t të equivalentit të CO ₂ Deri në një periudhë 10-vjeçare: xx t të equivalentit të CO ₂ Deri në një periudhë 7-vjeçare: xx t të equivalentit të CO ₂ Deri në një periudhë 14-vjeçare: xx t të equivalentit të CO ₂
Skenari bazë	Projektet CDM duhet të rezultojnë me shkarkime GHG më të vogla se sa

	zakonisht në Vendin Pritës. Në fazën e PIN-it këto janë pyetjet që duhet të marrin përgjigje: • Cilat shkarkime po zhvendos Mekanizmi i Propozuar për Zhvillim të Pastër (CDM)? • Si do të ishte e ardhmja pa një projekt CDM të propozuar? • Cili do të ishte reduktimi i parashikuar i shkarkimit të Gazrave Serrë në total? <i>(Rreth ¼ - ½ faqe)</i>
Vetëm për projektet e sekuestrimit: Vegjetimi dhe përdorimi ekzistues i tokës	<i>(Cila është sasia e tanishme e tokës dhe sasia në përdorim? A është sipërfaqja me pemë më shumë apo më pak se 30%?)</i>
Përfitime mjedisore specifike globale dhe lokale	<i>(Gjithsej rreth ¼ faqe)</i>
Cilat janë udhëzimet që do të përdoren?	Titulli dhe, nëse është e mundur, vendndodhja e faqes së Internetit
Përfitime lokale	
Përfitime globale	
Aspekte social-ekonomike Çfarë pasojash ekonomike dhe sociale mund t'i atribuohen projektit dhe të cilat nuk do të kishin ndodhur nëse nuk do të ekzistonte projektin? Tregoni komunitetet dhe numrin e njerëzve që do të përfitojnë nga ky projekt	<i>(Gjithsej rreth ¼ page)</i>
Çfarë udhëzimesh do të përdoren?	Titulli, dhe nëse është e mundur, adresa e faqes së Internetit
CILAT JANË EFEKTET E MUNDSHME TË DREJTPËRDREJTA (PSH: KRIJIMI I VENDEVE TË PUNËS. KAPITALI I NEVOJSHËM, PASOJAT E KURSIT TË HUAJ TË KËMBIMIT MONETAR?)	<i>Thjesht përmendni pasojat e mundshme të drejtpërdrejta</i>
CILAT JANË PASOJAT E TJERA TË MUNDSHME? PËR SHEMBULL: • TRAINIM/EDUKIM QË KA TË BËJË ME FUTJEN E PROCESEVE, TEKNOLOGJIVE DHE/OSE PRODUKTEVE TË REJA, DHE/OSE PASOJAT E NJË PROJEKTI NË LLOJET E TJERA TË INDUSTRIJË	<i>Thjesht përmendni pasojat e tjera të mundshme</i>
Strategjitë/Përparësitë mjedisore në Vendin Pritës	Një përshkrim i shkurtër i marrëdhënies midis konsistencës së projektit dhe strategjisë e përparsive mjedisore të Vendit Pritës (¼ faqe)

C. Financa

Kostoja totale e vlerësuar e projektit	
Kosto e zhvillimit	xx milionë USD/EURO

Kosto e zbatimit	xx milionë USD/EURO
Kosto të tjera	xx milionë USD/EURO
Kosto totale e projektit	xx milionë USD/EURO
Burime financimi për t'u eksploruar ose të identifikuar	
Aksione	Emri i Organizatave dhe financimi (në xx milionë USD/EURO)
Borxh – afatgjatë	Emri i Organizatave dhe financimi (në xx milionë USD/EURO)
Borxh – afatshkurtër	Emri i Organizatave dhe financimi (në xx milionë USD/EURO)
Të paidentifikuara	xx milionë USD/EURO
Kontributi i kërkuar në financim nga karboni	xx milionë USD/EURO
Kontribut financiar nga karboni nëpërmjet pagesave paradhënie (sasia e pagesës në dorë do të varet nga risku i vlerësuar i projektit kryer nga Banka Botërore.)	xx milionë USD/EURO dhe një shpjegim i shkurtër (jo më shumë se 5 radhë)
Burimet e financimit nga karboni	Emri i fiancierëve të karbonit (nëse ka të tillë)
Cmim orientues i CER-eve (i negociueshëm)	
Vlera totale e Marrëveshjes së Blerjes për Reduktimin e Shkarkimeve (ERPA)	
Një periudhë deri në vitin 2012 (fundi i periudhës së parë të buxhetit)	xx USD/EURO
Një periudhë 10-vjeçare	xx USD/EURO
Një periudhë 7-vjeçare	xx USD/EURO
Një periudhë 14-vjeçare (2 * 7 vjet)	xx USD/EURO
Nëse ekziston një analizë financiare për aktivitetin e propozuar CDM, të jepet parashikimi për vlerën e brendshme financiare të fitimit për projektin pa dhe me të ardhurat e CER-eve. Të jepet vlera financiare e fitimit duke marrë parasysh çmimin e pritshëm të CER-eve më sipër në USD/EURO equiv. 3/ tCO ₂ e. Ju lutemi të paraqisni një tabelë që i provon këto përllogaritje.	

Aneksi 3

Formati i një Letre Pranimit

Për: [Emri, adresa e zhvilluesit të projektit]

Data:

LETER PRANIMI

I nënshkruari, si përfaqësues ligjor dhe i autorizuar i Autoritetit të Caktuar Kombëtar të Shqipërisë,

Duke marrë parasysh se Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) më 1995,

Duke marrë parasysh se Shqipëria ka ratifikuar Protokollin e Kiotos më 2005,

Duke risjellë parasysh se Shqipëria dhe [emir i vendit blerës] kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi/Marrëveshje lidhur me zbatimin e projekteve CDM sipas Nenit 12 të Protokollit të Kiotos (ky tekst mbetet sipas rastit),

Duke iu referuar [Numri i propozimit si në formën e Aplikimit], propozuar nga [emri i zhvilluesit të projektit],

Deklaron se nuk ka vërejtje për zhvillimin e mëtejshëm të projektit [titulli i projektit] si një projekt CDM.

Autoriteti i Caktuar Kombëtar do të konsiderojë dhënien e një Letre Miratimi pas vlerësimit të projektit në fazën e ardhshme në përputhje me procedurat e rishikimit kombëtar dhe miratimit të projekteve CDM.

Firma:

[Vula]

Kryetari i Autoritetit të Caktuar Kombëtar për CDM-në
Shqipëri

Aneksi 4

Formati i një forme aplikimi për rishikim dhe miratim të një projekti CDM

FORMË APLIKIMI PËR RISHIKIM DHE MIRATIM TË PROJEKTIT ME
MEKANIZËM TË ZHVILLIMIT TË PASTËR NGA DNA-ja E SHQIPËRISË

Titulli i projektit:

Emri dhe Funkcioni i Aplikantit:

.....

Organizata:

.....

...

Adresa e Organizatës :

.....

.....

Tel: Fax:

.....

E-mail:

.....

Emri i partnerit/partnerëve të Projektit:

.....

.....

Aplikim për:

☐ Letër Pranimi

Bashkëngjitur:

- ☐ PIN-i (i detyrueshëm)
- ☐ Çdo dokument tjetër përkatës
- ☐ Përkthim të të gjitha dokumenteve në shqip (e detyrueshme)
- ☐ Variant elektronik të të gjitha dokumenteve në shqip dhe anglisht (e detyrueshme)

☐ Letter Miratimi

Bashkëngjitur:

- ☐ PDD-ja (e detyrueshme)
- ☐ Deklarim i pjesëmarrjes vullnetare në një projekt CDM (e detyrueshme)
- ☐ Kopje e Letres së Pranimi (nëse është kërkuar dhe është e disponueshme)
- ☐ Përmbledhje ekzekutive e Projektit në shqip (e detyrueshme)
- ☐ Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (nëse nevojitet)
- ☐ Çdo dokument ose informacion, nëse një gjë e tillë kërkohet në Letrën e Pranimi
- ☐ Leter Mbështetje nga bashkia ose ndonjë institucion tjetër përkatës (nëse është e nevojshme)
- ☐ Dokumente që vërtetojnë zotërimin e të drejtave për reduktimin e shkarkimeve në rast se ka më shumë se një palë të përfshirë në projekt
- ☐ Çdo dokument tjetër përkatës (p.sh.: raport i para-vlefësimi, leje për përdorimin e ujit, licensë për ndërtim dhe funksionim, marrëveshje për blerjen e energjisë; studim i fizibilitetit, etj.)
- ☐ Përkthime të të gjitha dokumenteve në shqip (e detyrueshme)
- ☐ Variant elektronik i të gjitha dokumenteve në shqip dhe anglisht (e detyrueshme)

Data e dorëzimit:

Firma e Aplikantit:

Vetëm për përdorim nga ana e DNA-së:
Numri i regjistrimit:

Anneksi 5

Formati i Letrës së Miratimit

Për: *[Emri, adresa e zhvilluesit të projektit]*

Data:

LETER MIRATIMI

I nënshkruari, si përfaqësues ligjor dhe i autorizuar i Autoritetit të Caktuar Kombëtar të Shqipërisë,

Duke marrë parasysh se Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndrshyimet Klimatike (UNFCCC) më 1995,

Duke marrë parasysh se Shqipëria ka ratifikuar Protokollin e Kiotos më 2005,

Duke risjellë parasysh se Shqipëria dhe [emri i vendit blerës] kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi/Marrëveshje lidhur me zbatimin e projekteve CDM sipas Nenit 12 të Protokollit të Kiotos (*ky tekst mbetet sipas rastit*),

Duke iu referuar [Numri i propozimit si në formën e Aplikimit], propozuar nga [emri i zhvilluesit të projektit],

Deklaron se miraton zhvillimin e mëtejshëm të projektit [titulli i projektit] si një projekt CDM.

Firma:

[Vula]

Kryetari i Autoritetit të Caktuar Kombëtar të CDM-së
Shqipëri

Aneksi 6
Formati i një Deklarate lidhur me pjesëmarrjen vullnetare në një projekt CDM

DEKLARATË

E PJESEMMARRJES VULLNETARE NË NJË PROJEKT CDM

Nëpërmjet kësaj deklarate, unë [*emri, funksioni*], në rolin tim si zhvillues projekti, pranoj se pjesëmarrja ime në projektin [*titulli i projektit*] që do të zbatohet në Shqipëri sipas Mekanizimit për Zhvillim të Pastër (CDM) të Protokollit të Kiotos, është krejtësisht vullnetare.

Firma: [*Zhvilluesi i projektit*]

[*Vula*]

Datë:

Aneksi 7

Sistemi i peshës dhe pikëve për kriteret e Zhvillimit të Qendrueshëm

KRITERET/NËN-KRITERET PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM	TREGUESIT	PESHA (100%)	PIKËT	NDIKIMI (PESHË X PIKË)
MJEDISORË		0.4		
Kontributi në zvogëlimin e ndryshimeve klimaterike	Shkarkimet GHG (gazra serrë) (reduktimi/ndalimi/sekuestrimi i shkarkimeve GHG në tonë CO ₂ eqv.)	0.2	+1 to +2	
Ndikime të tjera mjedisore	Shkarkimet/ndotja dhe/ose cilësia e përbërësve mjedisorë (psh: ndryshimi në nivelet e shkarkimeve/ndotjes dhe/ ose ndryshimi i cilësisë së përbërësve mjedisorë si uji, ajri, toka etj.)	0.12	-2 to +2	
Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore	Njësi fizike të burimeve (mënyra në të cilën përdoren burimet natyrore, psh: shkatërrimi/krijimi i pyjeve, përdorimi i tokës, ujrave, lëndëve djegëse, ndryshimi në produktivitetin e ekosistemeve lokale, etj.)	0.08	-2 to +2	
Nën- totali:				
EKONOMIKË		0.3		
Përfitimi financiar për entitetin/entitetet e projektit	Afati i veteshlyerjes pas investimit, norma e brendshme e fitimit, vlera aktuale neto (përmirësimi i këtyre treguesve falë financimit të projektit nga karboni)	0.105	0 to +2	
Transferimi i teknologjisë së re	Teknologjia e re e aplikuar (përdorimi i teknologjisë efikase me më pak ndikime negative ndaj mjedisit nga ajo e përdorur tradicionalisht)	0.105	0 to +2	
Tërheqja e investimeve të huaja	Flukset financiare (tërheqja e investimeve të reja, në përputhje me nevojat e aktorëve lokalë; kapitali i investuar në njësi monetare)	0.09	0 to +2	
Nën-totali:				
SOCIALE		0.15		
Reduktimi i varfërisë	Të ardhurat për banorët vendas, kushtet e jetesës (p.sh.: rritje/ulje në të ardhurat për frymë, variabla të tjera për cilësinë e jetës dhe varfërinë)	0.045	-2 to +2	
Konsultime publike	Konsultimet publike (numri i konsultimeve publike të	0.03	0 to +2	

	zhvilluara, si minimum ato që kërkohen nga VNM-ja, si edhe mënyra se si janë marrë parasysh komentet në planifikimin e projektit)			
Zhvillim kapacitetesh për aktorët e interesuar	Ndërgjegjësimi, aftësitë dhe mundësia për të marrë informacion (psh: rritje e ndërgjegjësimit, aftësitë, mundësitë për të marrë informacion nga ana e grupeve të ndryshme për çështje specifike të lidhura me ndryshimet klimatike dhe/ose zbatimin e projektit)	0.03	0 to +2	
Punësimi	Krijimi i vendeve të punës (p.sh.: numri i njerëzve të marrë në punë ose të shkarkuar nga puna, përfshi edhe vendet e punës të përhershme ose të përkohshme)	0.045	-2 to +2	
Nën-totali:				
POLITIKA KOMBËTARE		0.15		
Kontribut në përputhshmërinë me politikat qeveritare	Përputhshmëria me legjislacionin, strategjitë dhe planet kombëtare/rajonale/sectoriale (mbi bazën e rezultateve nga vlerësimi duke përdorur formatin e Tabelës 3)	0.15	0 to +2	
Nën-totali:				
Totali:				

Pikët maksimale që mund të marrë një projekt i vetëm janë 2, minimumi është -0.38. Një projekt me një pikavarazh nën 0.8 nuk propozohet për miratim.

Aneksi 8

Formë vlerësimi

Për projektin: *(titulli i projektit)*

Marrja e kërkesës për vlerësim: *(data)*

Vlerësues/e:

Emri:

Pozicioni/Institucioni:

VLERËSIM I PËRGJITHSHËM:

1. A është projekti CDM i propozuar në përputhje me kriteret e detyrueshme për kontribut në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe të gjitha politikat e tjera respektive kombëtare? (Ju lutemi të përdorni Tabelat 2 dhe 3).

Po/Jo (Komente nëse është e nevojshme)

2. Ju lutemi, jepni rezultatin përfundimtar pas plotësimit të instrumentit të zhvillimit të qendrueshëm për vlerësimin e projektit (Ju lutemi të përdorni Tabelën 4)

Rezultati i përgjithshëm:

REKOMANDIMI PËRFUNDIMTAR:

A rekomandoni miratimin e projektit të propozuar CDM dhe dhënien e Letrës së Miratimit?

Po/Jo

Nëse jo, jepni arsyet dhe sygjerimet/rekomandimet (nëse ka të tilla) për përmirësime të projektpropozimit. (Nëse është e nevojshme mund të përdorni fletë të tjera).

Shënim: Të gjitha formatet e plotësuara duhet t'i bashkëngjiten këtij dokumenti.

Firma:

Data:

ANEKSI 9

PERKUFIZIMI I TERMAVE QE PERDOREN NE FUSHEN E CDM-VE

Ne kuptim te kesaj Rregulloreje termat e me poshtem kane keto kuptime:

1. **Projekt CDM dypalësh:** Një projekt dypalësh është forma standarte e një projekti CDM dhe përfshin një investitor, një vend të zhvilluar dhe një vend pritës në zhvillim.
2. **Reduktim i Çertifikuar i Emetimit (CER):** Njësitë e fituara nga reduktimi i emetimit të gazeve me efekt serra, i gjeneruar nga aktivitetet e projektit të CDM-së. Një njësi është e barabartë me një ton metrik dyoksid karboni (CO₂) ose me ekuivalentin perkates te gazeve te tjera me efekt serra..
3. **Regjistri CDM:** Një bazë të dhënash elektronike standarte e ngritur dhe e mirëmbajtur nga Bordi Ekzekutiv i CDM-së që përmban elemente të përbashkëta të të dhënave që janë të rëndësishme për nxjerrjen, ruajtjen, transferimin dhe blerjen e CER-ve.
4. **Çertifikimi i CER-eve:** Garantimi me shkrim nga ana e Entitetit të Caktuar Operacional (DOE) që konfirmon se, pas verifikimit të tij, gjatë një kohe të caktuar, një aktivitet i projektit të CDM-së ka arritur reduktimin e parashikuar të shkarkimeve të gazrave serrë .
5. **Lëshimi i CER-ve:** Realizohet përmes një udhëzimi që Bordi Ekzekutiv i CDM-se i jep administratorit të regjistrit CDM për të regjistruar në një sasi të specifikuar CER-sh të fituara nga një aktivitet projekti, në përputhje me paragrafin 66 dhe Shtojcën D që përshkruan modalitetet dhe procedurat e CDM-së.
6. **Gaz Serrë (GHG):** Një ose më shumë prej gjashtë gazrave të renditur në Ankesin A të Protokollit të Kiotos të cilat akumulojnë nxehtësi kur çlirohen në atmosferë dhe përshijnë dioksidin e karbonit (CO₂), metanin, oksidin e azotit, ozonin, hidrofluorokarbonet (HFCs), perfluorokarbonet (PFCs) dhe heksafluoridin e squfurit (SF₆). Këto ndodhin në mënyrë të natyrshme ose të shkaktuara nga veprimtaritë e njeriut.
7. **Marrëveshje e Blerjes për Reduktimin e Emetimit (ERPA):** Rregullon çdo marrëveshje kontraktuale ndërmjet entitetit që është i autorizuar të shesë CER-t dhe një entiteti tjetër që ka nevojë t'i blejë CER-t dhe përfshin parashikime për dorëzimin, pagesat e CER-eve dhe detyrimet e ndersjella për të dyja palët.
8. **Monitorimi i një aktiviteti të një projekti CDM:** Monitorimi i referohet mbledhjes dhe arkivimit të të gjitha të dhënave të nevojshme për përcaktimin e pikënisjes, duke matur shkarkimet antropogjene nga burimet e Gazrave Serrë (GHG) brenda kufijve të projektit në një aktivitet të një projekti dhe përtej, sipas rastit.
9. **Konferenca e Palëve (COP):** COP-i përbëhet nga vende që e kanë ratifikuar ose janë pranuar në UNFCCC. COP-i është organizmi më i lartë qeverisës i UNFCCC-së.
10. **Vende të Aneksit I:** u referohet atyre vendeve të zhvillura dhe ekonomive në tranzicion të renditura në Aneksin I të UNFCCC-së, të cilat kanë rënë dakord me angazhimet jo-detyruese për të reduktuar shkarkimet e gazrave të lindura nga efekti serrë në nivelet e vitit 1990 deri në vitin 2000.
11. **Vend që nuk bën pjesë në Aneksin I:** Vende që nuk janë të renditura në Aneksin I të UNFCCC-së (në përgjithësi, vendet në zhvillim dhe ato më pak të zhvilluara).

12. **Vend Pritës:** Vend që nuk bën pjesë në Aneksin I dhe në të cilin është vendosur projekti CDM.
13. **Takim i Palëve (MOP):** Kjo ka të bëjë me takimet e të gjitha palëve që e kanë ratifikuar Protokollin e Kiotos. MOP-i i parë u zhvillua në dhjetor 2005 në bashkëpunim me COP11 në Montreal, Kanada.
14. **Entiteti i Caktuar Operacional (DOE):** është një entitet i pavarur ligjor i akredituar nga Bordi Ekzekutiv i CDM-së që mund të bëjë të vlefshme projektet e CDM-së dhe të verifikojë dhe çertifikojë reduktimet e shkarkimit të Gazrave Serrë. Përdorimi i të njëjtit DOE për disa projekte jo të vogla CDM kërkon pranim paraprak nga Bordi Ekzekutiv i CDM-së. Për projekte të vogla CDM, mund të kontraktohet i njëjti DOE pa miratim paraprak.
15. **Bordi Ekzekutiv (BE)** (referuar gjithashtu edhe si Bordi Ekzekutiv i CDM-së): Bordi Ekzekutiv i CDM-së mbikqyr CDM-në, nën autoritetin dhe drejtimin e COP/MOP-it, si dhe jep llogari përpara COP/TP-së.
16. **Shtesë (Shtesë Mjedisore):** Ka të bëjë me reduktimin e shkarkimeve të Gazrave Serrë nga burimet ose largimin e tyre nëpërmjet përthithjeve që vijnë si shtesë e çdo pakësimi që do të ndodhte në mungesë të projekt-aktivitetit CDM. Termi është deklaruar në Marrëveshjet e Marrakeshit, ku saktësohet se një projekt-aktivitet perben aktivitet shtesë nëse shkarkimet antropogjene të Gazrave Serrë janë reduktuar më shumë nga sa do të ishin reduktuar në kushtet e mungesës së projektit CDM. Nga ky këndvështrim, shpesh kjo shtesë quhet edhe Shtesë Mjedisore.
17. **Pyllëzim:** Ka të bëjë me konvertimin e drejtpërdrejtë nga njeriu të tokës që nuk është pyllëzuar për të paktën 50 vjet në tokë të pyllëzuar nëpërmjet mbjelljes, hedhjes së farës dhe/ose promovimit nga njeriu të burimeve të farërave natyrore.
18. **Deklarata e Depozitimit:** Eshtë deklarata e cila mund t'i jepet Bordit Ekzekutiv të CDM-së nga Pjesëmarrësit në Projekt.
19. **Pikënisja:** I referohet skenarit që përfaqëson në mënyrë të arsyeshme shkarkimet antropogjene nga burimet e Gazrave Serrë të cilat do të ndodhnin në kushtet e mungesës së aktivitetit të propozuar nga projekti.
20. **Perqasja bazë:** Eshtë themeli i metodologjisë bazë. Bordi Ekzekutiv ka rënë dakord se tri perqasjet e identifikuara në nën-paragrafet 48 (a) deri (c) të modaliteteve dhe procedurave të CDM-së të jenë të vetmet që do të aplikohen për aktivitetet e projektit të CDM-së. Këto janë:
 - (i) Shkarkimet ekzistuese aktuale ose historike, sipas rastit;
 - (ii) Shkarkimet nga një teknologji e dhene që, nga pikëpamja ekonomike, përfaqëson një kurs tërheqës veprimi, duke marrë parasysh pengesat për investime; ose
 - (iii) Shkarkimet mesatare të aktiviteteve të ngjashme të projekteve, të ndërmarra gjatë pesë vjetëve të fundit, në rrethana të ngjashme sociale, ekonomike, mjedisore dhe teknologjike dhe performanca e të cilave bën pjesë në 20 përqindshin më të lartë të kategorisë së tyre.
21. **Periodha Kredituese:** Periodha për të cilën projekti i CDM-së mund të gjenerojë CER-e për reduktimet e pranueshme të shkarkimeve.
22. **Periodha e Parë e Angazhimit:** Periodha midis viteve 2008-2012, gjatë së cilës vendeve të Aneksit I në Konventën e Ndryshimeve Klimatike u kërkohet të

- redukojnë shkarkimet e Gazrave Serrë në nivelet e përcaktuara nga Protokollin i Kiotos.
23. **Marrëveshjet e Marrakeshit:** Vendimet 2/CP.7 deri tek Vendimi 24/CP.7 (duke e përfshirë edhe atë) të sesionit të shtatë të COP/MOP-it.
 24. **Paneli i Metodologjisë (shkurt: Met Paneli):** Paraqet propozime specifike për t'u konsideruar nga Bordi Ekzekutiv p.sh. lidhur me vlerën e pikënisjes së re të propozuar dhe metodologjitë e monitorimit.
 25. **Zbutja:** Një ndërhyrje antropogjene për të pakësuar burimet ose për të shtuar përthitjet e gazrave serrë.
 26. **Ndihma Zyrtare për Zhvillimin (ODA):** Ndihmë dypalëshe dhënë zyrtarisht qeverisë dhe e disbursuar në mënyrë të përvitshme nga një vend i Anekesit I tek një vend që nuk bën pjesë në Aneksin I, ne rastin konkret, te vendi yne.
 27. **Kohëzgjatja operationale:** Përcaktohet si periudha në të cilën është në funksionim e sipër një aktivitet i projektit CDM. Asnjë periudhë kreditimi nuk duhet të zgjasë përtej kohëzgjatjes operationale (e përlllogaritur qysh nga data e fillimit).
 28. **Aktivitet Projekti:** Një aktivitet projekti është një masë, operation ose një veprim që synon të redukojë shkarkimet e gazrave serrë. Protokollin i Kiotos dhe modalitetet e procedurat e CDM-së e përdorin termin "aktivitet projekti" në vend të fjalës "projekt". Një aktivitet projekti mund të jetë identik ose një pjesë përbërëse ose një aspekt i një projekti të ndërmarrë ose të planifikuar.
 29. **Kufijte e Projektit:** Kufijtë kombëtarë që rrethojnë një Projekt aktual ose të propozuar CDM brenda të cilit janë konsideruar dhe kuantifikuar ndikimet dhe pasojat e shkarkimeve të Gazrave Serrë.
 30. **Periudha e konsultimit publik:** ndonjëherë i referohemi edhe si proces konsultativ me aktorët e interesuar ku zhvilluesi i projektit fton aktorë të cilët mund të kenë pasoja nga projekti për t'ua shjeguuar atyre projektin, për t'ju përgjigjur pyetjeve dhe për të qartësuar çështje që janë me interes për publikun. Zhvilluesi i projektit, si pjesë e zhvillimit të PDD-së duhet të përmbledhë edhe mënyrën se si është organizuar periudha e konsultimit publik dhe si janë pasqyruar komentet e publikut.
 31. **Ripyllëzimi:** Konvertimi i drejtpërdrejtë, nëpërmjet ndërhyrjes së njeriut, i tokës së shpyllëzuar në tokë të pyllëzuar nëpërmjet mbjelljes, farërave dhe /ose promovimit nga ana e njeriut e burimeve të farërave natyrore në toka që kanë qenë të pyllëzuara por që janë konvertuar në tokë të shpyllëzuar. Për Periudhën e Parë të Angazhimit, aktivitetet e ripyllëzimit do të kufizohen vetëm në ripyllëzimin që ndodh në ato toka që nuk kanë pasur pyje më 31 dhjetor 1989.
 32. **Aktor/ë:** Publiku, përfshi individë, grupe ose komunitete që ndikohen ose ka gjasë të ndikohen nga aktiviteti i propozuar i projektit CDM.
 33. **Data e Fillimit:** Data e fillimit e një aktiviteti të projektit CDM është data në të cilën zë fill zbatimi ose veprimi konkret i një aktiviteti të projektit.
 34. **Tabela e transaksioneve:** Sipas Marrëveshjeve të Marrakeshit, tabela e transaksioneve krijohet nga sekretariati në mënyrë që UNFCCC-ja të verifikojë vlefshmërinë e të gjitha transaksioneve që kanë të bëjnë me të drejtat e Protokollit të Kiotos përfshi CER-et brenda ose midis regjistrave (edhe atë midis një regjistri kombëtar dhe regjistrat CDM). Tabela do të mbulojë nxjerrjen, transferimin, blerjen, anulimin, tërheqjen ose kalimin në periudhën e mëpasme të angazhimit të çdo të drejte të Protokollit të Kiotos.

35. **Regjistrimi:** Pranimi zyrtar i një projekti të bërë të vlefshëm si projekt CDM nga ana e Bordit Ekzekutiv. Regjistrimi është parakusht për verifikimin, certifikimin dhe dhënien e CER-eve që kanë të bëjnë me këtë projekt.
36. **Projekt CDM i njëanshëm:** Një projekt i Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër i zhvilluar dhe i zbatuar nga një palë/entitet i një vendi në zhvillim(jo vend i Aneksit I).
37. **Dhënia e vlefshmërisë:** Është procesi i vlerësimit të pavarur të një aktivitet-projekti nga një DOE e përcaktuar përkundër kërkesave të CDM-së ashtu siç janë përcaktuar në marrëveshjet e Marrakeshit dhe në bazë të Dokumentit të Hartimit të Projektit.
38. **Verifikimi:** Rishikimi i pavarur periodik dhe përcaktimi ex post nga ana e DOE-së për reduktimet e monitoruara në shkarkimet antropogjene nga burimet e Gazrave Serrë që kanë ndodhur si rezultat i një aktivitet-projekti CDM gjatë periudhës së verifikimit.